




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Drejtoria për Arsim - Odeljenje za Obrazovanje - Department of
Education



Datë/Datum/Date:	28.04.2020
Referenc-ë	230
Nga/Od/From:	Drejtoria Komunale për Arsim, drejtori: z. Avni Morina
Subjekti/Predmet/Subject:	Njoftim për shtyerjen e afatit të aplikimit në konkursin për ndarjen e bursave studentore



Të nderuar studentë të komunës së Rahovecit,

Drejtoria Komunale për Arsim, për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia COVID – 19, pasi ka shpallur konkursin me nr.prot:221, të datës 07.04.2020, jep këtë:

Njoftim

Ju njoftojmë nga Drejtoria Komunale për Arsim, se për shkak të gjendjes së krijuar si rezultat i pandemisë COVID-19 dhe për shkak të masave të rrepta të kufizimit të lëvizjes për qytetarë, shumica e studentëve të komunës sonë nuk patën mundësi të aplikojnë sepse nuk kanë mundur t'i nxjerrin dokumentet e nevojshme për të aplikuar nga administratat e fakulteteve përkatëse. Si rezultat i kësaj, numri i aplikantëve për bursë pranë DKA-së gjatë këtyre ditëve ishte shumë i vogël.

Për këtë arsye, DKA ka vendosur të zgjasë afatin e aplikimit për bursa deri në një njoftim tjetër. Pra, **studentët mund të aplikojnë për bursa edhe pas datës 05.05.2020**. Shpresojmë që sa më shpejtë ta tejkalojmë këtë gjendje!